



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 6914
Data: 22.08.2022

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR ME HENDIKOS DHE KOMITETIN PËR
PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Procesverbali nga Dëgjimi i parë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025, të mbajtur me datën **19.08.2022**, duke filluar nga ora **11:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 27 pjesëmarrës, prej tyre 14 gra dhe 13 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, Nënkryetari i Komunës, **z.Sevdi Dernjani**, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, **z.Florim Shkreta**, si dhe drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2023, si dhe parashikimi për vitet 2024-2025, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi thekson: Ne kemi dhanë disa propozime, kemi pasur edhe Qarkoren e parë Buxhetore, dhe sipas asaj e kemi kalu në Kuvend dhe tani jemi në fazën e dëgjimeve publike për projektet që ne i kemi paraqitur, për t'i parë edhe ju se çka kemi në projeksionet buxhetore tona për këto vite dhe t'i marrim idetë dhe propozimet tuaja sipas kërkesave dhe nevojave tuaja që i keni, kështu që po mundohemi që me të gjitha kategoritë shoqërore të jemi në kontakt për të realizu një plan buxhetor, i cili do të kalojë disa faza, duke përfshirë Kuvendin, dëgjimet dhe pastaj prapë vjen në Kuvend, kështu me 30 shtator është data e fundit ku do të miratohet buxheti për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025. Ne kemi bashkëpunu me të gjitha drejtoritë që kemi, kemi bërë disa propozime, kemi marrë parasysh edhe kërkesat e qytetarëve për projektporpozimet që ata na i kanë paraqit gjatë dëgjimeve të para, por duke pasur parasysh që kemi buxhet të limituar, por që kemi përfshirë disa që janë më me prioritet. Prezentimin e këtij draft buxheti do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Ashtu sikur në jetën private, çdo individ me të hyrat që inkason, bën një planifikim për kostot e tij të jetës, për veshmbathje, për ushqim dhe shpenzime të tjera. Ashtu edhe në rastin e Komunës, buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave që bëhet së fundi deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur konsulta me asamblesë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2023 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,431,545€), granti specifik për arsim (993,487€), granti specifik për shëndetësi (364,561€) dhe të hyrat vetanake komunale (560,121€). Pra, buxheti total për vitin 2023 do të jetë 3,349,714€. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2023, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore. Mandej vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i kemi para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor dhe nuk po ju detajeve. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

2. Diskutimi

Mehmet Ballazhi: Nëse dikush nga ekzekutivi, drejtorët e drejtoreshat ka me shtu diçka, edhe pse ne të gjithë bashkë i kemi planifiku dhe e kemi punu këtë draft buxhet. Madje sot, ne e diskutuam projektin e ashensorit në institucionet publike, përkatësisht në komunë, kryesisht për nevojat e juaja duke pasur parasysh vështirësive që mund të hasni. Por nëse ju keni ndonjë ide apo projekt propozim, ju kisha lut që mos të hezitoni, kjo nuk do të thotë se të gjitha propozimet do të miratohen e realizohen sepse kemi kufizime buxhetore dhe ne bazohemi gjithmonë tek kufinj të buxhetorë që kemi.

Nerxhivane Berisha: Unë e kisha propozu një projekt që në qytet me pas pjerrina nëpër trotuare, që të kemi qasje, ku trapat po janë shumë të lartë e me karrocë po ka vështirësi, ku të njëjtën kërkesë e kam parashtrur edhe te Komiteti.

Mehmet Ballazhi: Këtë çështje dhe çështje të tjera si ajo e parkimit për automjete, që do ta kemi në plan. E kemi diskutu që së paku të ketë parkingje edhe nëpër qytet, jo vetëm tek qendrat tregtare Viva, edhe pse nuk respektohen ato parkingje nga persona të pandërgjegjshëm, e ky lloj shenjzimi nuk është as e kushtueshme, kështu që e kemi në plan edhe këtë gjë.

Nerxhivane Berisha: Një kërkesë tjetër që kemi në fushën e shëndetësisë, ka shumë anëtarë të Handikosit që kanë nevojë për një rehabilitim, janë së paku 10-15 persona, e që kanë edhe përcjellës disa e me pas mundësi që me u subvencionu këta persona për rehabilitim ose me ua mundësu me fizioterapeut ose diçka edhe në shtëpi me ua mundësu si lloj terapie, 2-3 herë në javë.

Mehmet Ballazhi: Për punën e rehabilitimit, sivjet ne veç jemi në fazën e përgatitjes për me i subvencionu 10 persona të shoqatës Handikos, dhe për ne jeni kategoria më e vlefshme, ku edhe pse kemi buxhet të limituar, po mundohemi që s'paku 10 personave me iu ofru një rehabilitim prej 10 ditësh në banjë dhe jemi në procedurë.

Nerxhivane Berisha: Është edhe çështja e shkollës, ku ka anëtarë të Handikos që nuk ka shkollim ose veç me 8 vjeçare dhe me ua siguru mbajtjen e shkollimit të mesëm.

Mehmet Ballazhi: Ne e kemi diskutu edhe bashkë këtë çështje, dhe kjo nuk varet krejt prej nesh, por edhe gatishmëria e shkollave tjera, se ne këtu në Han të Elezit nuk mundemi me bo, por në bashkëpunim me Komunën e Kaçanikut do të shohim se cilat janë mundësitë.

Nerxhivane Berisha: Kemi pas një diskutim me Drejtoreshën e Shëndetësisë, e cila na e ka dhanë mundësinë që ua siguru barnat që janë shumë të shtrenjta, dhe bisedum që me caktu një ditë kur anëtarët me i çu recetat e mjekut për barnat që kanë te drejtoresha, normalisht për ato që munden, sepse kanë diagnoza të ndryshme dhe të shtrenjta.

Mehmet Ballazhi: Kjo hyn në kategorinë e subvencionimeve, e lista esenciale e shëndetësisë është prej Ministrisë, por jashtë kësaj, ne kemi me u mundu me plotësu diçka çka mundemi, e kërkesën e juaj drejtoresha na e ka paraqit, por edhe unë e di pak a shumë këtë nevojë dhe kërkesë tuajën, por çështja është te mundësia buxhetore se sa ne mundemi me subvencionu.

Kimete Kuka Hasallari: Kisha shtu diçka në këtë pikë, që nëse keni mundësi me i listu barnat që keni sa ma shpejt që të mundeni, pra barnat e secilit prej juve dhe se sa i përdorni gjatë vitit sepse e kemi një procedurë të veçantë që jemi tu dashtë me e furnizu me barna që s'janë në listën esenciale, dhe që aty të shtijmë edhe barnat e juaja.

Ismet Ballazhi: Për këtë çështjen e barnave për personat me aftësi të kufizuara, a do të merret vendim sa më i shpejtë.

Nerxhivane Berisha: Drejtoresha e tha që ne sa më shpejtë të bëjmë një listë me barnat që i përdorim, ju mi sillni recetat mu dhe unë i shkruaj krejt dhe ja përcjelli drejtoreshës. Edhe pse

zyrën nuk e kemi funksionalizu hala edhe pse Kryetari na e ka dhanë mundësinë për me shfrytëzuar një zyrë në Shpi t'Kulturës dhe jemi tu kshyr me Up to Youth që na e ka ofruar një grant për me pajisur zyrën me inventar, kështu që këto receta mundeni me mi sjellë mu te shpia. Ne si handikos duhemi me bo një takim me krejt, se sot këtu janë veç pak, e diskutoj me ta dhe ua sjelli listën me barnat dhe sasinë.

Mehmet Ballazhi: Unë isha një ditë te zyra juaj, dhe mirë e kishit bo me ato mbishkrimet dhe e kisha si ide që miër kishte me qenë me pas numër të kontaktit të dikujt të shoqatës, që të jemi në kontakte, meqenëse edhe kushtet janë aty, ku ka edhe ashensor.

Nerxhivane Berisha: Një organizatë na e ka ofruar një grant prej 5,800€ që shpresojmë ta fitojna, dhe si ide e kemi me e bo si një kioskë për me shit punime ose gjana ushqimore, diku kah qendra e komuna me na e dhanë lejen, atë kioskën e ban krejt ajo organizata, por na duhet veç leja e komunës dhe vendi ku me vendos.

Mehmet Ballazhi: Kjo nuk bëhet për shpejt, sepse duhet me u bo një planifikim e ne po mundohemi me i liru hapësirat dhe për me vendosur një kioskë, ne duhemi të bëjmë planifikime, por njëherë t'i lirojmë disa hapësira e më pas të shohim se si mundemi me i sistemu disa të tjera.

Qani Bushi: Është problem puna e trenit, ato mbikalimet ku po osht pak e vështirë e deshta me pyt çka ka me pas për aty.

Mehmet Ballazhi: Ne kemi pas një takim ku prezent kanë qenë edhe banorë të lagjes anej, edhe nga KVRL-ja, edhe unë jam banor i asaj lagje, e poashtu në takim ishin edhe nga Infrakos e Trainkos dhe menaxheri i projektit, e ata na e dhanë si një lloj propozimi ku u vendos që përfundimisht me u rregullu ai mbikalim që është, por duke ia shtu edhe rampën me standarte të duhura. Ne nuk e kemi pa projektin, por ky ka qenë premtimi i fundit që na e ka dhënë Infrakosi, kjo është në kuadër të tyre, ata kanë me investu aty, e ne mundemi me iu ndihmu në aspektin administrativ, përndryshe do të mbetet ai mbikalim, por i riparum me rampa apo atë pjerrinën

Nerxhivane Berisha: Sa e di, te ETC ka me u hapur një restaurant, dhe deshta me dit se a duhem me bo unë si OJQ kërkesën për ashensor apo mundet me ndërhy edhe komuna me e bo një ashensor aty që me pas qasje edhe na.

Mehmet Ballazhi: Atë që ne mundemi me bo është me ua përgatit dokumentacionin e nevojshëm për me bo kërkesa, por iniciativat janë tuajat.

Valentina Thaqi: Shumica e këtyre që u thanë, këto janë edhe kërkesat që parashtrihen edhe në Komitet. E një nga kërkesat e Hamim Kaloshit, që sot s'qenka prezent, është që kërkohet një fizioterapeut te QKMF-ja sepse ai bashkë me gruan e tij detyrohen të shkojnë në Gjilan.

Mehmet Ballazhi: Për këtë çështje, ndoshta kishim mundur me kontakt me kompani private për me na mbështet, përndryshe ne e kemi numrin e caktuar të të punësuarve që s'mundemi me dal jashta asaj. E në Han të Elazit, nepërveç fizioterapeutë kemi mungesë të personelit mjekësor që janë të shumtë, si stomatologë, psikologë, logopedë, etj. Por do të shihet mundësia që herë pas herë të ofrohet fizioterapi.

Nerxhivane Berisha: Unë kisha pas një kërkesë, që personat me autizëm që shkojnë në atë qendrën ku i majnë konsultimet, e me mujt komuna me ua siguru transportin së paku në dimër.

Mehmet Ballazhi: Ne kërkesat tuaja i marrim, do t'i shqyrtojmë, do të hulumtojmë për me i gjet mënyrat ma t'mira se si me e realizu.

(Fjalën e rastit e merr Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z.Florim Shkreta, i cili i përshëndeti dhe i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje)

Florim Shkreta: Çështjen e personave me aftësi të kufizuara, ne vazhdimisht e kemi diskutuar dhe e diskutojmë si ekzekutivë, biles Drejtoresha e Administratës e ka paraparë një ashensor për objektin e komunës, që me iu mundësu juve që në të ardhmen me pas qasje te salla e Kuvendit, që edhe ju me hy në listë të garës si të tjerët.

Lindita Ballazhi: Ne i kemi shënuar të gjitha kërkesat e juaja dhe të gjitha do të shqyrtohen dhe do të japim maksimumin që së paku disa të ua realizojmë. Çfarëdo kërkesë që keni, jo vetëm nëpër dëgjime, por çdo herë dyert tona janë të hapura në çdo kohë.

Mehmet Ballazhi: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor për Handikos.

Mbledhja përfundoi në ora 11:34.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



